



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

01 / 611
15-06-23
PRISHTINË - A

KGJK. Nr. 242/2023
Datë: 12 qershor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragraf 1, pika 1.14, dhe 1.25, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në ankesën disiplinore të Raiffeisen Bank Kosova, ndaj vendimit ADGJTHFR.nr.5/23, të datës 25 prill 2023, të Autoritetit Kompetente të Gjykatës Themelore në Ferizaj, në mbledhjen e 310-të, të mbajtur me datë 12 qershor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

Hedhet si e pa lejuar ankesa e disiplinore e Raiffeisen Bank Kosova, ndaj vendimit ADGJTHFR.nr.5/23, të datës 25 prill 2023, të Autoritetit Kompetente të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 31 maj 2023, ka pranuar ankesë nga Raiffeisen Bank Kosova, J.S.C, me adresë në Rr."Robert Doli", Prishtinë, me propozim për shqiptimin e masës disiplinore ndaj Faton Ajvazi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Ankuesi Raiffeisen Bank Kosova, ankesën e ka ushtruar në KGJK i pakënaqur nga vendimin disiplinor ADGJTHFR.5/23, të Autoritetit Kompetent/Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, me të cilin vendim është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Faton Ajvazi.

Ankuesi në këtë çështje pretendon se vendimi i Autoritetit Kompetent ADGJTHFR.nr.3/23, i datës 23.03.2023, me të cilën është refuzuar ankesa e tyre për iniciim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Faton Ajvazi, nuk është i drejtë dhe me këtë vendim e ka shfajësuar gjyqtarin Faton Ajvazi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 12 qershor 2023, pasi e shqyrtoi dhe vlerësoj pretendimet ankimore të vendimit të ankimuar, duke u bazuar në nenin 7, paragraf 1, pika 1.14, dhe 1.25, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 dhe 7, të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e Raiffeisen Bank Kosova, J.S.C, me adresë në Rr."Robert Doli", Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit ADGJTHFR.5/2023, të datës 25.04.2023, të Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Ferizaj është e pa lejuar.

Në këtë drejtim, Ligji 06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i ka dhënë mundësin secilit person fizik dhe juridik që të parashtrij ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo të Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën t'a përcjell tek Autoriteti Kompetent, mirëpo nuk ja ka dhanë mundësinë ligjore personave fizik dhe juridik që të parashtrij ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kompetent tek Këshilli kur Autoriteti Kompetent e ka refuzuar ankesën disiplinore, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Në këto rrethana, KGJK duke vlerësuar ankesën e parashtruar se bashku me shkresat e bashkëngjitura sa i përket pretendimeve ndaj vendimit ADGJTHFR.nr.5/23, të datës 25.04.2023, të Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Ferizaj, konstatoj që ankesa është e pa lejuar.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.242/2023, datë: 12 qershor 2023



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Raiffeisen Bank Kosova, J.S.C, me adresë në Rr. "Robert Doli", Prishtinë;
- Mustaf Tahiri, Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj.